

MISIONI I SHQIPES DHE I SHQIPTARËVE

(Historia, Gjuhësia dhe Mendësia e Shqiptarëve në Syrin Inxhinierik)

prof. Sazan **GURI**¹

PËRMBLEDHJE

Dihet se njeriu ka lëvizur shumë ngadalë në evolucionin e vet, aq sa pas 120 mijë vjetësh arriti të mbërthejë një shkop si penë me dy gishta, aq sa mbas një milion vjetësh arriti të formojë dhe të ruajë zjarrin (40 mijë vjet më parë), por ne do të rrekemi me periudhën qysh nga shpikja e rrotës (12 mijë vjet më parë) ose me periudhën pas ciklit të fundit akullnajor (25-18 mijë vjet më parë), që çuditërisht përkojnë me ngrohjen globale ose me përmytjen e madhe, me hirin më të madh vullkanik të njohur deri më sot dhe me periudhën pas-atlantide të humbur, që të mbërrijmë tek fatet e stisura, të ngarkuara, të popujve të stisur. Kjo është dhe historia më mirë e njohur sot për mbarë njerëzimin, ku cikli i fundit akullnajor bëri që njerëzit anekënd hapësirave të akullta veriore të shtegtonin dhe të përziheshin me njerëzit e hapësirave të ngrohta. Kështu shpjegohet fakti që fiset e stepave tëpas Kaukazeve, disa prej të cilëve të quajtur fise *ariane* zbritën dhe u shkruinë me fiset e mesdheut të sotëm, nga ku ne kemi kulturat, gjuhët dhe sjelljet e para, ku njeriu filloi të matej me njëri-tjetrin dhe me natyrën. Është koha kur, për tre mijë vjet, njeriu studioi sjelljet e kafshëve për të selitur sjelljet e veta, mandej sjelljet e yjeve për të shpjeguar ndodhitë e mëdha, si të ftohtin e klimës, hirin vulkanik, përmytjen e lidhur me të ngrohtin e klimës, etj.

Fjalë Kyçe: *cikli akullnajor, elementë glotologjikë, ngrohje globale, përmytje, hiri vullkanik, raca e gurit, gjuha shqipe.*

HYRJE

Pas një milion vjetësh mbijetesë të njerëzimit, pas dhjetë mijë vjetësh përpjekjesh të këtij njerëzimi për kulturë, gjuhë e dije për të zotëruar e përdorur natyrën, Zoti cakton dhe binjakëzon dy prindër (izraelitët dhe shqiptarët), që të kujdesen t'i ruajnë si në pergamenë ato. A e kanë përmbushur këtë rol këta dy prindër të njerëzimit?! *Po flasim për racën e gurit, e cila mbi këtë lloj material ka ngritur të gjithë konstitucionin e saj juridik apo "gjuridik", sepse betohet mbi "gur", profetizon me ndihmën e gurit dhe i lutet Zotit para gurit.*

1. MISIONI I SHQIPES DHE I SHQIPTARËVE

1.1 Evolimi i njeriut parak


Historia e njeriut sipas historianëve fillon në të njëjtën kohë me aktivitetin e trurit të tij, gjë kjo që mendohet të ketë filluar gati 50.000 vjet të shkuara.²Ajo që mund të shënohet për periudhën dy milion

¹**inxhinier, Studjues i historisë dhe etnokulturës shqiptare*

²*The Reader's Digest Association, The last two million years, fq. 16, v. 1973*

vjeçare është se njeriu evolonte shumë shumë ngadalë, aq sa krahasohet me shembullin metaforik, se njeriut i është dashur 120,000 vjet vetëm të mbante penën me dy gishtat e njerës dorë. Deri në vitin 200,000, njeriu le të themi pak si egër, akoma nuk i kishte vajtur mendja të përplaste dy gurë stralli për të krijuar zjarrin. Madje, as nuk bëzante, sikur edhe një tingull apo zanore, por ndoshta shenjat dhe britmat si primatët e vet (majmunët) përbënin komunikimin e tyre. Dhe vjen momenti. Natyra veproi me ndryshimet e saj graduale, duke sjellë hopin (mbrekullinë), pikërisht në kapërxyellin e këtij momenti, (200,000 vjet para) njeriut i ndodh t'i zbresë ezofagu nga prapa qafës në pozicionin që ne gëzojmë sot.³ Ky mund të jetë revolucioni më i rëndësishëm i parahistorisë njerëzore, sepse solli kushtin e parë të artikulimit të fjalës. Përgjat akullnajës së fundit, (118,000 -18,000 vjet), toka, arriti pikën e saj më të ftohtë, rreth 22 mijë vite më parë gjatë të ashtuquajturit Maksimumi i Fundit Akullnajor, ku përkon me zhdukjen e njeriut para homosapiens, siç qe *Neandertali*, që ndryshe quhej nga njerëzit e asaj kohe si *i le apo i shpikur në andër*. Për 25,000 vjetët e fundit, homo sapiens sapiensi u bë i vetmi lloj njeriu të paktën në tokën europiane. Në ciklin e fundit akullnajor, një racë si neandertali, austrolopiteku, etj., nuk ia dolën dot të mbijetonin. Njerëzia, për shkak të të ftohtët u rrudh dhe iu drejtua mesdheut, përfshirë Afrikën e veriut, Mesdheun dhe Egjeun që përbëjnë shtëpinë e parë të madhe të njeriut parak, për të cilën do t'i ngelte mision historik zhvillimi dhe mbrojtja e tij.

Rreth 40 mijë deri 30 mijë vjet më parë, kur Evropën e kishin mbuluar akullnajat, në rajonet e trevave shqiptare sot apo parake europiane, si në Xarë (Sarandë), Kryegjatë (Fier), Gajtan (Shkodër), gjendeshin tehe stralli, si vegla për të nxjerrë rrënjë nga toka. Në Shën Marenë (Sarandë), në Lanabregas (Tiranë), Kryegjatë (Fier), Gajtan (Shkodër)⁴ janë zbuluar vegla e mjete pune⁵ që na flasin se shoqëria njerëzore e at'hershme kishte bërë hapa përpara, p.sh: *Ajo kishte zhvilluar gjuhën dhe ishte lidhur më ngushtë me punën. Jeta ngjiz qysh nga Paleolitiku i mesëm - gjurmë të para të zbuluara në Gajtan, rrëzë malit Dajti, Xarë, Shën Mëri (Jug), vazhdon me Paleoloitikon e hershëm - shfaqja e homo sapiens (rreth 35,000 vite më parë). Njeriu i parë europian, që ne sot themi, ata të ardhur prej thellësisë së historisë *pe larg – pellazg*, mendoheshin Pellazgët, të cilët ushqeheshin me farat e lisit ose ishin ngrënës të lëndëve të lisit. Në periudhën pas akullnajore kemi fillesat e bujqësisë dhe drithërave rreth 6500 vjet para krishtit*



³Dokumentar shkencor Kanadez në Explorer TV

⁴Myzafer KORKUTI, Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri, fq. 14, v. 2010

⁵Që Ilirët e kanë një prejardhje të lashtë në këto troje dhe se ne jemi pasardhës të denjë të këtij civilizimi, flasin shumë studime, jo vetëm të studiuesve shqiptarë, por numri më i madh i tyre është nga ata të huajt. Në suazat e shkencës së mirëfilltë, teoria tanimë e dëshmuar e prejardhjes së shqiptarëve të sotëm nga ilirët e lashtë, askund nuk diskutohet. Gjurmët e para materiale dhe më të vjetra të pranisë së jetës në këto troje, janë zbuluar në fshatin XARRË (afër Sarandës). Këto janë: vegla pune, armë, stoli, enë nga dheu, etj. Prejardhja e tyre daton që nga koha e paleolitit të lartë, që vazhdon afërsisht 40.000 - 6.000 vjet para erës sonë. Po ashtu është interesante zbulimi në shpellën e SHËN MARINËS (në Bogaz të Konispolit) të eshtrave të një dhie të egër, e cila i takon llojit "CAPRA IBEX", lloj ky i cili është zhdukur dhe nuk ekziston më, gjë që dëshmojnë mbi ekzistimin e lashtë të jetës në këto troje, me një gjueti të zhvilluar.

me zona mesolitike të zbuluara në Shqipëri si në Blaz 1, Treni, Spileja. Ndërsa, *neolitiku* (8000-3000 vjet) është koha që stërgjyshërit shqiptarë banonin në rajonin e Kretës dhe Azisë së Vogël, shumë më parë periudhës Eneolitike 3000 – 2000 vjet, siç e dëshmojnë dhe gërmimet në Maliq, Kamnik, Nezir, Hisar, Ohër, Troja I dhe II. *Neolitiku* – 5000 - 4000 vjet para krishtit, koha që zë vend shfaqja e ndërtimeve megalitike në europën perëndimore. *Eneolitiku* – rreth 2000 vjet para krishtit, epoka e bakrit, kohë gjatë së cilës ndodh zbutja e kalit, prodhimi i verës në Evropën juglindore.⁶

Banesat e para të njeriut parak

Banesat e para të tyre, tashmë ishin shpellat, vendi ku banonin arinjt e pëllumbat e egër. Ndaj, edhe shumë shpella të ne (Gajtani, Treni, Skorrana në Erzen, etj.) ende quhen shpella e ariut ose shpella e pëllumbave, sepse në to gjenden jashtëqitjet e tyre dhe më pas ato të njerëzve.⁷ Termi shpellë mund të jetë fjala e parë e njeriut parak european, që gjën shpjegim nga pikëpamja etimologjike vetëm me anë të shqipes *si vend që s'pe*. Prej saj, buroi edhe fjala tjetër që lidhet me banimin, mbasi paraku european doli nga *shpella*, dhe e quajti atë *shpi*.

Dalja në skenë e mbinjeriut të “vojtur”, por më i ditur

Dhe mbas daljes prej shpelle, njeriu parak european që ndoshta deri në këtë moment nuk ishte pagëzuar ende, del në qiell të hapur ndeshet me natyrën dhe me nevojën për kërkim, tashmë në grupe më të mëdha. Por, në memorie ruante gjëmën që i ndodhi prej të ftohtit të madh. Dhe nuk i mjaftoi kjo ‘reminishencë’ e së kaluarës, ai (njeriu parak) u ndesh me një ngjarje po aq të madhe, siç ishte hiri vullkanik që ka mbuluar një pjesë të mirë të rruzullit rreth viteve 12,000 para k.⁸ Pra, njeriu parak, mbas kësaj ngjarje prodhoi një njeri tjetër apo bëri të delte mbinjeriu, i “vojtur”, por më i ditur. Toka kishte filluar të përfshihej 9000 vite më parë nga një periudhë e ngrohtë (Hypsitherma), e cila arriti kulmin rreth 6000 vite më parë. Kjo ka bërë shkrirjen e akujve dhe rritje të nivelit të detit, aq sa Egjeu u derdh furishëm në Detin e Zi dhe kemi atë që quhet përmbytja e madhe. Kjo përbën mbijetesën e tretë të parakut European që e detyron atë të studiojë natyrën, botën dhe lëvizjet e kafshëve, si dhe astrologjinë si pozicionet e yjeve, rolin e diellit, të hënës dhe ligjet midis tyre.



Shpikjet e para të njerëzimit

⁶*Që njeriu të ketë pritur kaq gjatë për të zbutur kafshët, si qenin 8000 vjet para, kalin 2000 vjet, nuk na i do mendja se mund të jetë pikërisht kështu. Ndërkohë që dokumentarët e sotëm shkencorë vertetojnë se kafshët kanë qenë bashkudhëtarë të njerëzimit qysh në agimet e tij. Me patjetër që njeriu i ka pasur pranë kafshët e shtëpisë qysh kur njeriu filloi aktivitetin mbi natyrën pas shpikjes së zjarrit, kur gjuante në grup, etj., dhe më pranë akoma të paktën pas daljes prej shpellave 12,000 vjet përpara, por jo 2000 vjet para krishtit.*

⁷Perikli QIRIAZI, *Shpella e pëllumbasit, Gryka e Skoranës, Tiranë.*

⁸Më sakt, 11,700 vjet më të cilën fillon moshë gjeologjike Holocenit.

Mendohet se për 3000 vjet rrjesht, njerëzia e at'hershme, paraku europian, por tashmë me emër pellazgu, studiuuan njëherësh si botën lart në qiell dhe ligjësitë e natyrës këtu në tokë, le të përmendim largësitë apo distancat midis yjeve, tokës, duke ndërtuar kalendarët e parë, teoremat si ajo e Pitagorës, që një nga një do t'i shohim në këtë libër. Stacioni mezolitik i Kryegjatës është më i studiuar, e rrjedhimisht më i rëndësishmi për të njohur këtë epokë në vendin tonë.⁹


Njerëzit bënë dhe riparimin pajisjet e gjahut, materialet prej druri, kocke, lëkure, etj. Në aspektin kohor, aktiviteti mezolitik i Kryegjatës përkon me epokën e Holocenit të hershëm, 11,700 vjet më



parë, me një kohëzgjatje një ose dy mijë vjeçare. Pikërisht, 10 mijë deri 7 mijë vjet para erës sonë, njerëzit filluan zbutjen e kafshëve dhe mbjelljen e bimëve. Konispoli dhe Kryegjata me zbulimet e bëra tregojnë se qenë kryer hapat e parë drejt blegtorisë dhe bujqësisë primitive, ku periudhën e lulëzimit të vet, bashkësisia primitive e pati gjatë neolitit dhe vazhdoi rreth 4 mijë vjet (7 mijë deri 3 mijë vjet para e.s). Muret pellazgjike të kalasë së Coldronit (fisi Sellëve apo Selijeve) rrëzë malit të Tomorrit, gjithë krahina e Gramshit, ku gëlojnë familjet me mbiemrat Zela, janë vazhduesit e këtij populli.

Një nga shpikjet e para të njerëzimit, duke na dëftyer se pothuajse ligjet e rëndësishme janë shpikur njëherë dhe më vonë, ato janë veçse zbulime nga pluhuri i harresës së kohës, ose hireve vulkanikë ose qëllimeve dashakeqëse të vetë njeriut.¹⁰ Ato u quajtën në atë kohë "shtatë artet e lira" që u bënë themel i të gjitha njohurive për shoqërinë njerëzore. Shumë testamente dhe mbishkrime gjenden brenda mureve të piramidave, që duke u zbrëthyer na kujtojnë shpesh shpikjet e bëra njëherë, siç janë: gjoja shpikjet e kohës së lashtë greke, si ajo e Pitagorës, që kur studenti i vet i thot – maestro - këtë teoremë e kam parë edhe në leximet s(h)umere, dhe që merr përgjigjen që mos e thuaj më herë tjetër.

Shiko kuptimin e piramidës së diellit dhe precizitetin e ndërtimit, bazë mbi të cilën janë ngritur piramidat në tokë. Këto shpikje të bëra nga pellazgët 10,000 vjet para krishtit, janë marrë në shqyrtim sot në vitet '90 nga matematicieni Kroat Milankoviç, i cili matematizoi dhe shpjegoi me anë të tyre të gjitha lëvizjet gjeologjike det – tokë. Pra, thjesht i zbuloi nga pluhuri i haresës, sepse ishin shpikur njëherë.¹¹



Ja disa prej zbulimeve të shumta të bëra njëherë në kohën e pellazgëve, diku në egje, diku në egjypt, diku në sirakuzë, diku në azinë perëndimore, diku në Ararat (rrëzë të Kaukazeve), etj.: trekëndshi egjyptian 3 x 4 x 5, trekëndëshi barabrinjës, etj.; distancat nga dielli, nga ylli Sirius, nga kashta e kumtrit,¹² etj.; pigreku grek 3.14; jo rastësisht është edhe festa e

⁹Myzafer KORKUTI, Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri, fq. 14, v. 2010

¹⁰Xhemail GASHI, Studime albanologjike, mbledhur nga hulumtuesi i gjuhës dhe veprave të shqiptarëve, Besir Bajrami.

¹¹Sazan GURI, Stratigrafia sekuenciale, v.2012

¹²Shikoni fjalën kumtri dhe krahasoheni me fjalën qumësht të shqipes, prej së cilës kupton se ai popull që studioi për herë të parë ligjet e astronomisë ishin, vecse të parët e shqiptarëve.

ditës së verës në muajin 3, dita e 14; numëri i ditëve të vitit të pasqyruara, jo më kot, në shkallët e piramidave deri te gatimet tradicionale, si tava me kos e me mish qengji, që egjiptologu Zitchin e gjeti në të vërtetë në ish turizmin e Elbasanit, sikundër e kishte të lexuar në brendësi të njërës prej piramidave të Egjiptit.¹³ Në këtë kontekst, thot studiuesi në ditët e sotme Maksim Zotaj se është shumë me vend që ta theksojmë se ‘*historia e shqiptarëve zë një vend me peshë të madhe në historinë e civilizimit botëror!*¹⁴ Ndaj studiuesi tjetër, gjuhëtari Lirim Muho që gjithë jetën ia kushtoi studimeve pellazgjike pohon dhe shton në llogjizmen e Engelsit se: *Po të mos ishte Athina nuk do të ishte Roma, po të mos ishte Roma nuk do të ishte rilindja europiane dhe po të mos ishte rilindja nuk do të ishte europa, por asnjë nga këto nuk do të ishte - shton studiuesi Muho – nëse nuk do të ekzistonte më parë historia pellazge.*¹⁵

1.2 Popujt e parë të etnisë pellazge

Gjithsesi, koha kur u formësua trunngu parak european duhet të lidhet me periudhën e daljes prej shpellave, aty para mijëvjeçarit të 12 para krishtit, por që u përballën me rastin kataklizmo përmytje dhe me rastin tjetër hi vullkanik, pas një përvoje të hidhur me të ftohtin akullnajor. Ndaj, iu drejtuan ligjeve të kozmosit, pozicioneve tokë, hënë e diell, ligjësive të natyrës, rregullave të kafshëve, duke sjellë nevojën e të jetuarit bashkë, të paktën për një periudhë pesë mijë vjeçare deri diku në mijëvjeçarin e shtatë para krishtit. Pas kësaj periudhe, ku fillon e zgjerohen paralelet e ngrohta, nevoja urbane dhe ajo bujqësore bëri të lindin shtegtimet e para si në figurën e mëposhtme. Është koha, kur gjithë fiset e trungut pellazg (keltë, galë, baskë, iberët, etj.) jetonin bashkë e togje togje. Por, në midis viteve 4000-3500 para krishtit, pellazgët me hititët bëjnë bazën dhe fqinjësinë vëllazërore me popujt e tjerë, si ato semitike apo me sumerët, prej nga shtegtojnë iberët (të parët), baskët (që qëndruan bashkë), keltët (të kaltrit) dhe galët. Kësisoj gjuha e formuar për termat astrologjikë, kalendarët, ditët e javës, planetët, për produktet bujqësore ishin dhe janë ende një, por një popull i ruan si at’herë. Jo rastësisht është ky popull parak dhe pasardhësit e tij direkt (shqiptarët, por në veçanti gegët) që ende përdorin kalendarët e parë të njerëzimit me emra tipikisht shqip, si vjelja e parë për shtatorin, vjelja e dytë për tetorin, farori për shkurtin që hidhej fara, kallnuer për janarin, meqenëse ishte koha kallkan, dimën për dhjetorin meqenëse ditët ishin të mnuara, të zemëruara, korrik për të korrurat, Mars i m(b)arë), etj.¹⁶

Periudha e errësirës pas luftës së Trojës

Shtegtimi i fundit është ai i Dorianëve drejt Peloponezit në vitet 1100-800 para krishtit, pikërisht koha, kur zuri vend errësira e fiseve pellazgëve pasi bën Trojën. Është koha kur ata (pellazgët) e tregonin me rapsodi Trojën, por mbi të gjitha është koha kur këta dorianë, fis brenda fiseve pellazge u përzierin apo u bashkuan me ata të paktë (larosh, pak si esmerë, pas si arab, pak si nga Fenikasi apo pak si nga Egjipti), të cilët kërkuan pak tokë, fillimisht sa për të futur kokën, pastaj pak arë buke për të ushqyer

¹³ZITCHIN, *The twelfth planet, NY, U.S.A. v. 1976-2006*

¹⁴Maksim ZOTAJ, *Dodona pellazge,*


¹⁵Lirim Muho, *Atje ku lindën profetët, v. 2016*

¹⁶Sazan GURI, *Kalendarët, Gazeta Panorama, 08 janar 2014*

fëmijët e së fundi pakëz tokë publike për shkollë, art, kulturë e podiume për rapsodi. Në këtë rrokopujë shekuj, sa errësirë për një popull si pellazgët që kishin 10,000 vjet që bënë histori, aq rast për tu ngritur një popull i ri, u deshën 400 vjet që të ngjizej një klasë e re, fillimisht e urtë, dhe mbasi siguroi elementët bazë të sipërmendur, ata u kthyen në të ‘dhunshëm’. Sinteza është e thjeshtë?! A nuk është po ky lëshim që në shek. - V e VI pas krishtit, shqiptarët iu bënë sllavëve të jugut dhe katër shekuj më pas (shek.-VII deri në shek. - XI) errësire, ata morën diktat dhe vuajtje pa fund prej tyre? A nuk është po ky rregull, ende sot, ku një shqiptar, duhet të harrojë nga vjen, duhet të ndërrojë emër dhe duhet të shndrrojë fe apo besim, sikundër bëri me vetveten Aristoteli (2400 vjet më parë) i ardhur nga treva thrake, e pastaj me Aleksandrin e Madh nga Emathia (Mati), e megjithë ata që iu mësonte të njëjtën filosofi helene, nga at’here e sot e motmot.¹⁷

Pellazgu në shkrimet e të mëdhenjve të antikitetit

Për herë të parë emrin e pellazgëve e përmend Homeri në veprën e tij madhore “Iliada”, ku shkruan se: *tani do të përmend ata, që Argosin pellazgjik banonin...Hipothou solli fiset pellazge fqinjë, ata të cilët banonin Larisën pjellore*¹⁸. Po Homeri në një veper tjetër të tij¹⁹ i ka quajtur pellazgët: *fisi i Zeusit – fis hyjnor – dhe gjuhën që ata flisnin e quante po aq hyjnore, e jo greke*. Nga pothuajse të gjithë studiusit pranohet se Pellazgët formonin një “perandori” të madhe, ku përveç territoreve të Egjeut, Azisë së vogël, Afrikës së veriut dhe Ballkanit të sotëm, ata përfshiheshin në mjaft vende të Europës Lindore e Perëndimore. Për rolin që kanë lojtur në formimin e popujve dhe kulturave të tjera, ata janë dhe mbeten popull historik dhe nga më të vjetrit në Ballkan e në Europë. Perandorinë dhe lashtësinë e tyre e shpreh edhe Pindari, që duke i karakterizuar ata, shprehet se: *Ata janë njerëz të para detit*²⁰. Me patjetër që edhe poeti i madh Naim Frashëri këtu e ka pasur pikënisjen, kur mendonte se shqiptarët janë në këto troje qysh para Hënës²¹. Sepse, vetë Pindari studius, gjeograf dhe historian i lashtësisë, fjalë për fjalë shprehej për pellazgët se: *ata qenë të lindur para hënës*.



Ç’ishin Pellazgët?

¹⁷Mos u çudisni të dashur lexues, kur përpiqemi të lidhim popujt e Emathisë me atë të Matit, sespe kështu ka ndodhur historikisht me popujt, kur ata shpërnguleshin. Sigurisht që ata i emërtojnë vendet ku venë sipas atyre të vjetrave, të cilat iu duhej t’i braktisnin. Kështu emri i lashtë i Maqedonisë ishte Emathia (shqip: e madhja) dhe pellazgët, të detyruar të shpërngulen në drejtim të trevave të sotme shqiptare, e emërtuan krahinen malore Matia ose Mat. Po kështu pohon edhe Virgjili, se heronjtë e mundur të Trojës bënë të njëjtën gjë kur u shpërngulën në Butrint. Po kështu edhe arbëreshët pas Skënderbeut në Italin e Jugut.

¹⁸Homeri, Iliada, II, 681, v. 2006

¹⁹Homeri, Odiseja, kënga VI, vargu 26, v. 1973

²⁰Pindari, Carminia, Fragmenta Selecta, vol. I, fq. 240, *Portando un bel dono, la Terra fece nascere per primo l’essere umano nell’ARCADIA, il “DIVINO PELASGO”, molto prima della luna.*

²¹Naim FRASHËRI,

Pellazgët e parë ishin një popull gjahtar, pastaj barinj dhe më pas bujq-blegtorë²² dhe më në fund, metalurgë të shkëlqyer dhe ndërtues të mrekullueshëm fortesash dhe muresh rrethues të quajtur ndryshe ciklopikë ose pellazgjikë. Një nga themelimet më të hershme është Lepenski Vir, në brigjet e Danubit në ish-Jugosllavi. Ajo daton 5500 P.K dhe kishte jo më pak se 59 shtëpi, të ndërtuara prej druri dhe guri. Suksesi i njerëzve të Lepenski Vir dhe Eynan ishte tregimi i aftësive të zhvilluara për gjueti. Hapi tjetër ishte zbutja e kafshëve dhe kjo ishte një ndër gjërat më të mira. Dr. Josip Korosheci flet për këto themelime e të tjera si këto²³ në kontekstin se: “*Varret në Trebenishtë janë Ilire*”. Të njëjtën gjë e pohon edhe Vasil Llahnov, arkeolog i shquar, i cili ka shkruar se²⁴: “*Bartës dominant të kulturës së Trebenishtës, kanë qenë Ilirët*”;

Që kjo popullsi është marrë me bujqësi dëshmojnë mbeturinat e bykut të gjetura në plot stacione të zbuluara në shumë gërmime në rrethin e Fierit e kudo gjetkë²⁵. Byku i përzier me baltë është përdorur në vend të llaçit e të çimentos për shtrimin e dyshemeve. Njerëzit e kësaj kohe ishin mjeshtër të punimit të tokës, ndaj edhe quheshin ndryshe arban, si njerëz që arën e kthejnë në produkt bujqësor, pra e b(ë)ajnë. Më parë, ata arrinin që tokën shterpë ta kthenin në tokë arë. Kështu, tokën lëndinë e shterpë përreth malit Hermes, afër Athinës e punuan mirë dhe morën prodhim të bollshëm, duke e kthyer në tokë pjellore. *Athinasit, kur panë se pellazgët e kthyen tokën djerrë e të pavlefshme në tokë pjellore, ua morën dhe i dëbuan prej andej.* Një nga këto rrëmbime rrëfëhet në pllakën e Lemnosit, e cila zberthehet me gjuhën shqipe nga studiuseja Ermin Vlora Falaksi dhe prof. Muharrem Abazaj. Ja pse Aristoteli flet për ilirët: që bëjnë verë nga mjalti, që përshkruan dhe teknologjinë e prodhimit të saj. Sipas tij, verën e mjaltit e prodhonin vetëm ilirët ku shënon”...kurse tani thonë që ajo bëhet edhe në disa vende të Heladës”. Ilirët shfrytëzonin me mjeshtëri edhe bletët, nga të cilat merrnin mjaltin dhe dyllin që e përdornin edhe si mall për shkëmbim. Edhe Stefan Bizantini dëshmon se: Ilirët ishin mjeshtër të rrallë. Ata me një teknologji të tyre origjinale, duke e përpunuar mjaltin, prodhonin verë që ishte e njëjtë dhe ndoshta më e mirë se e rrushit. Në pemëtari, vendin kryesor e zinte hardhia-rrushi, për të cilin ata kujdeseshin më shumë. Kujtojmë se: *kur hardhitë*



²²Sipas një kronike vendase të botuar më 1975, **në fshatin Arnishtë, në perëndim të Tomorrit**, një shekull e ca më parë u zbulua një parmendë e lashtë prej hekuri, dëshmi se dikur aty bujqësia ishte e lulëzuar sikurse sot tek evropianët.

²³Josif KOROSHECI sipas Dr.Dushko, Hr. Konstantinov shkrim i botuar në Muzeun Popullor të Manastirit, nr. 1 mars 1966,

²⁴Vasil LLAHNOV, sipas Jakov MILAJ, Racat Shqiptare, v. 1995

²⁵Kristo FRASHËRI, **Delet, siç dëshmon Herodoti, çmoheshin shumë nga apolloniatët (përfshirë edhe ilirët): ato janë të shenjta për ta.** Ilirët shfrytëzonin me mjeshtëri edhe bletët, nga të cilat merrnin mjaltin dhe dyllin që e përdornin edhe si mall për shkëmbim. Aristoteli flet për ilirët që bëjnë **verë nga mjalti**, që përshkruan dhe teknologjinë e prodhimit të saj. Sipas tij, verën e mjaltit e prodhonin vetëm ilirët, ku shënon”...kurse tani thonë që ajo bëhet edhe në disa vende të Heladës”. Edhe Stefan Bizantini dëshmon: se ilirët ishin mjeshtër të rrallë. Ata me një teknologji të tyre origjinale, duke e përpunuar mjaltin, prodhonin verë që ishte e njëjtë dhe ndoshta më e mirë se e rrushit. Në pemëtari, vendin kryesor e zinte hardhia-rrushi, për të cilin ata kujdeseshin më shumë.

franceze harbohen apo infektohen keqasi, agronomët francezë sot, vijnë e marrin në Shqipëri kalema e filiza të rinj që të rigjenerojnë, si mëma me qumështin e saj fëmijën, vreshtat e sëmura të tyre.²⁶

1.3 Ilirët para apo pas Helenëve

Korinthiotët thoshin se “ne themeluan qytetet për t’u bërë hegjemonë të tyre”²⁷ por kjo nuk eci, vec tregtisë me shtetet e Epirit dhe të Ilirisë. Pyetja vazhdon të jetë dhe mbetet po ajo, nëse janë gjindur njerëz para se të vinin kolonët grek në këto qytete apo jo? Patjetër se po! Madje, vetë Ilirët kanë kryer kolonizime shumë më para se të hynin grekët apo korinthisit në lojë apo në histori, sikundër nënvizon studiuesi J.Bouzek-u se: *duke filluar nga bronzi i hershëm, ilirët kanë zotëruar detin Adriatik*²⁸. Ndaj, si Ilirët dhe Epirotët kishin vendosur marrëdhënie tregtare me Japyginë dhe Enotrinë qysh në kohët paragreke. Nga ana tjetër, termi *koloni* në Epir dhe në Iliri si në Itakë dhe Solion p.sh., ndryshe nga territoret greke quhen *qendra të vogla korinthjote për tregti, ndërsa në territoret greke quhen polis-e*. Sipas burimeve letraro-historike të autorëve të vjetër grekë, vendasit e Korkyrës quheshin “liburnë” ose “eretrianë”. Ndaj dhe Plutarku sqaron se grekët e vjetër i quanin nganjëherë popujt në vende të huaja “eretrianë”.²⁹ Dhe korkyrasit e asaj kohe si pjesë epirote në përgjithësi silleshin ndaj korinthjotëve (kolonistëve) me përbuzje³⁰ dhe nuk kanë bërë marrëveshje me asnjë grek”. *Jo rastësisht, Apollonia e Durrësi zbulohen deri në masën 5%, se po të zbulohet pak më tepër se 6 apo 10 apo 20 apo 50%, do të dalë me patjetër kultura e varrosur pellazge.*³¹ *Pa lë qytetet si Zhgërdheshi, Dimali, etj., aty ku nuk ka shkel këmbë heleni, nuk gërmohet e nuk gërmohet.*

Shtrirja e fiseve ilire para ardhjes së kolonëve grek dhe para pushtimeve romake, çka verteton se në këto treva gëlonte qyteti dhe qytetërimi para se të zgjoheshin për ngulitje qytet polis-e e sapo formuara si Korinthët, etj. (mirënjohje Eva Brinjës)



Dhe kur pa dashur del ndonjë vazo ilire apo ndonjë mbishkrim ilir, kujdesi ka qenë sesi ajo të lexohej me anë të këtyre gjuhëve, që të fortët shkruajtën historinë botërore (shih figurën në mbishkrimin e gjetur në Apolloni), ku shumë syresh të ndershem

²⁶Francezët, ende e mbajnë gjallë teorinë se vera apo vena që pi kushdo sot në botë ka dalë nga Iliria. Arkeologu Neritan CEKA tregon për enë mbajtëse vere (amfora) të gjetura në ishujt e Greqisë, shumë kohë më parë se të hynin grekërit e latinët në skenën e historisë. Ato silleshin prej tregtarëve nga Dyrrahu e qendrat e tjera. Gjetëm edhe pjesë të një amfore me vulën e ishullit Rod, që dëshmon për sjelljen e verës nga mijëra kilometra larg.

²⁷Tukididi, I, 38, 2,

²⁸Citim sipas Arsim SPAHIU, Shteti Epirot, fq. 61, v.2011

²⁹Plutarque, De Pyth. Or., 16 ; Quest. Gr.epirot, i Arsim SPAHIU, v.2011

³⁰Tukididi I, 31, 2, citim sipas fq. 61 te libri Shteti Epirot, v.2011

³¹**Për Apoloninë:** “Edhe pse me qindra e qindra përmendore të rëndësishme të historisë së kulturës u mbartën për ndërtim kishash ndërmjet Vlorës e Semanit dhe më tutje në Berat e Vlorë, edhe pse shumë kultura u çuan jashtë vendit në kohën e Turqisë e të Luftës Botërore /1914-1918/, prapësëprapë toka e Pojanit është shumë e pasur në monumente, aq e pasur sa asnjë vend rrënojash në krejt Evropën.

prej tyre, sot e pranojnë botërisht, se na është dashur të falsifikonim historinë, se ndryshe se si do delnim ne parakët europianë, më sakt si do të justifikonim forcën e një race gjoja superiore që kishte të drejtën të pushtonte, të ndante e të priste. Kështu është Apollonia, kështu është Durrësi, ku pjesa autoktone i ngjet ajsbergut nën ujë e nëndhé.

Ndaj është rrënuar Bylisi, ndaj është shkatëruar Amantia, Plloca, Epiri, që tregonin 100% popullsi autoktone. Por, për këto fakte do të flitet herë pas here në faqet e këtij libri. Një ndër faket është se kultura e periudhës së parë të hekurit, që njihet edhe në Bylis, Nikaia (Klos), Margëlliç, Gurzezë etj., ka pasur nivel të lartë zhvillimi para se të nguleshin kolonët helenë në Apolloni e Myzeqe. Zhvillim më të madh, kjo kulturë e mori në fazën e dytë të hekurit (shek. VIII-VII p.k) dhe në fazën e tretë (shek VI-V p.k). Le të marrim disa qytete, për ilustrim të konceptit të mësipërm, si Butrintin, Durrësin, Apolloninë, Beratin, Lezhën dhe Shkodrën, të cilët nuk janë themeluar nga Helenët (Fig. - 53), siç e kemi mësuar me dashje apo pa dashje nga historia jonë e shkruajtur. Përkundrazi, janë të shumta burimet, ndër to, ajo e prof. Apollon Bace, që thonë se: *gjashhtë qytete të Shqipërisë aktuale, së bashku me Athinën dhe San Hosen e Meksikës përbëjnë qytetet më të vjetra të njerëzimit.*

Një fakt të tillë pohohet edhe nga arkeologu i njohur shqiptar, Hasan Ceka, i cili nga studim-gërmimet e veta ka nxjerrë përfundime se: *Durrësi ka qenë themeluar nga Ilirët, para se këtu të nguleshin Helenët të Korkyrës*³². Po në këtë sens është edhe prof. Kristo Frashëri, që me anë të një studimi mbi monedhat Ilire arrin në konkluzionin se: *Ilirët, pra qytet-shtetet e mësipërme janë të dytët në Europë që krijuan bankat, ku fillimet e monedhës, kreditit dhe bankës janë kryer me anën e trambit, këmbimit (mall për mall), dhe këto janë zhvilluar të paktën që në mesin e mijëvjeçarit të II p.e.s.* ³³ Ndërtuesit e parë të Dyrrahut kanë qenë ilirët. Kjo është vërtetuar nga arkeologët, të cilët kanë zbuluar në qendrën e sotme të qytetit gjurmët e vendbanimit të hershëm ilir, i cili ishte themeluar rreth vitit 650 p.Kr. Për sa më sipër, këto fakte i përforcon edhe studiuesi Stefan Bizantini, ku thot se: *Epidamni është formuar si qytet nga ilirët shumë kohë para se të dukeshin grekët e parë në detin Adriatik.* Problemi qendron sikundër thot studiuesi shqiptar Arsim Spahiu te historianët shqiptarë: ³⁴ *që nuk binden se kapitujt më të lavdishëm të historisë së vjetër të Shqipërisë janë shtrembëruar rrënjësisht, për t'u grabitur plotësisht.*

Diskutime mbi teorinë pellazgjike

Pellazgologjia moderne, e mbështetur gjithashtu mbi punimet e pothuaj 500 dijetarëve të kohës së re, është duke u rritur dhe zgjeruar orë e çast në rrafsh universal. Argumentet sipas pellazgologut të 'degdisur' Dh.Pilika, do të huazohen ind e majë, vetëm nëpërmjet kriteresh rreptësisht shkencore nga

³² Hasan CEKA, *Illyrie, Etudes et materiaux archeologiques, Vol. I, v.1971*

³³ Kristo FRASHËRI, *Historia e qyteterimit shqiptar, v.2008, Dora-dorës me të, nevoja i shtyu njerëzit të praktikonin edhe huanë (kreditin), duke praktikuar edhe kaparin. Monedha e tyre ishte deri në Danub. Shikoni të dashur lexues sesi termat e kësaj kohe juridike në koncept si bie fjala këmbim, kredit dhe kapar shpjegohen dhe shpëtohen etimologjikisht me anë të shqipes. Fjala këmbim del nga ajo kam-kamb-këmbim, këmbëj si punë e këmbëve, prej nga burojnë fjalët latine dy apo tre rrokëshe caminare, gamba, cambiare apo ajo angleze came, change, etj. Po kështu, edhe kredit që do të thotë këmbim me kre dele apo kokë dele, lopë apo dhi që në vendin tonë ka qenë e udhës deri në ditët e sotme, apo kapar-kap arën si peng deri sa të sillet malli. Më gjerë për këto shpjegime shih fjalorthin në libërin e dytë.*

³⁴ Arsim SPAHIU, *Shteti Epirot, fq. 64, v.2011*

historiografia, arkeologjia, numizmatika, epigrafia, sfragjistika, gjuhësia, etimologjia, onomastika, etnografia, folkloristika, jurisprudenca, antropologjia, hematologjia, ekonomia, statistika, demografia, gjeografia, gliptografia, qeramologjia, historia e artit, zoologjia, botanika, etj.³⁵ Le të marrim vetëm njerën prej tyre si Numizmatika, e cila si një disiplinë shkencore ekzakte, ndihmëse fort e vyer e historigrafisë. Në rastin mbi pellazginë sjell gjithashtu disa argumente-çomangë, që nuk të lënë të lëvizësh shtrembër. Dhe së bashku me disiplinat e tjera, të paktën, të arrish të diskutosh për teorinë pellazgjike, duke u munduar që të ndërtosh pyetje për akademikët, gjuhëtarët, historianët deri në “gente komune-njerëz të zakonshëm”, dhe sa mund të marrësh përgjigje për çështje se si:

- *pellazgët - ilirët ishin stërgjyshët e shqiptarëve;*
- *pellazgët - ilirët, me emra të ndryshme, d.m.th. me emra të fiseve pellazgo - ilire (gegë, toskë, albanë, arbër, arnautë, dardanë, maqedonë, hetitë a hititë, trojanë, egjiptianë, etruskë, etj.) jetonin në një trevë shumë të gjerë dhe në tri kontinente: në Evropë, Afrikën Veriore dhe në Azi, deri në Iran dhe Indi;*
- *ilirishtja - shqipja, si degë më e vjetër e familjes së gjuhëve indoevropiane, është çelës i qytetërimit njerëzor;*
- *nga gjiri i ilirëve dolën shumë perëndi, profetë, perandorë e dijetarë;*
- *stërgjyshët e shqiptarëve, pellazget - ilirët, me kulturën e tyre të lartë kontribuan, jo vetëm në civilizimin e popujve të tjerë, të cilët i sundonin, por me anë të vetë asimilimit, kontribuan në krijimin e shumë kombeve dhe kulturave (feve, gjuhëve, shkrimeve) të veçanta në tri kontinente;*
- *shkatërrimi i pellazgëve - ilirëve të shumtë dhe të kulturuar u shkaktua, jo vetëm nga katastrofat natyrore, por edhe nga luftrat e brendshme që u zhvilluan mes fiseve të tyre, luftë kjo që vazhdoi tradicionalisht deri në ditët e sotme dhe që deri diku justifikohet, sepse duhet të “ziheshin” këta që të ngjizeshin protoplazmat e popujve të tjerë, por jo ende sot që jemi para një ere të re, siç është globalizmi;*
- *nga bërthama e pellazgëve - ilirëve shumë të lashtë - vetëm shqiptarët mbetën pa u shkrirë në popuj apo kombe të tjera - në grekë, hebrej, arabë, italianë, austriakë, sllavë të jugut, turq, etj.;*
- *janë gegët, që në një masë të madhe, ruajtën shqiptimin e ilirishtes - shqipes së lashtë;*
- *Dorianët, Lidianët dhe Frigianët, si vllëzër të një trungu pellazg kishin për gjuhë bazë atë rrokjore;*
- *në shek.-V p.e.s., Herodoti i quan molosët shkoqur “pellazgë”,³⁶ ashtu sikurse Straboni gjashtëqindujet më pas.³⁷*
- *Janë cilësuar si “të mbirë nga dheu” (Hesiodi, shek. VII p.e.s.), apo “preselenitë” (parahënorë), pra të stërlashtë, lindur në tokë “para se të shfaqej hëna” (sipas gojëdhënash popullore të lashta).³⁸*
- *A kanë folur qesim këta studius gjeografë?! Aq sa, shumë syresh grekë, sipas A. Mateë, Herodotin, babain e gjeografisë së lashtë, e quajnë tradhtar, sepse ka dekonspiruar teorinë greke.³⁹*
- *Akili legjendar (Fig.-105), merret si kryegjysh pellazg i molosëve (fragment mozaiku – Apoloni), ku vërehet gjakmarrja e Akilit për kushëririn Patrokël, e ballafaquar gjithashtu edhe me tumulimin e tij prej vetë Akilit, do të mjaftonte për të saktësuar përfundimisht pellazgësinë e heroit, rit dhe institucion, ende sot ndër shqiptarë.*
- *Pse Homeri e thekson besa-besën e Akilit pellazg, pas lutjes që i drejton këtij Priami për dorëzimin e trupit të të birit, Hektorit, dhe për lejen që të*



³⁵Dhimiter PILIKA, *Pellazget, Origjina jonë e mohuar*, v. 2005

³⁶HERODOTI, *Historia, Libri VIII, II, 9*

³⁷STRABONI, *Geografika, Vol. 1*

³⁸Hesiodi, citim 700 vjet para krishtit, rreshtat e fillimit të Teogonisë 'Genesis of the Gods'.

³⁹Aref MATHIEU, *Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen*, v. 2007

silleshin nga jashtë qytetit të rrethuar drutë e zjarrit për kodërvarin e të rënit.

Fig. – 105 Akili legjendar, me veshjen e vet karakteristike si një pastor, ku mund t'i vësh një sërë orendish dhe shenjash zvasitike, sikundër mbajnë ende sot malësorët shqiptarë.

- pse mbi disa enë antike kundrohet qartazi një lloj fustanelle e Akilit, e cila haset thuhet identike edhe sot e kësaj dite në troje shqiptare.⁴⁰
- në teatrin antik të Bylisit gjejmë të njëjtin modul arkitektonik, si në atë të Dodonës. Teatri ku rrinë ulur 18.000 spektatorë, duke qenë kështu teatri më i madh i kohës.
- Aleksandri i madh që e mbante veten si stërnip i Akilit, pasi kreu flijimet e zakonshme, ia mbuloi tumën me lule, duke pëshpëritur fjalë thrake për stërgjyshin e vet.

Fig. – 106 Pamje e një vazoje, që gjendet sot në muzeun e Luvrit, ku qartazi vëren gjakmarrjen e Akilit, sikundër bënë ndër shekuj popujt me bazë pellazge apo ilire deri te shqiptarët e veriut, veprim i rregulluar me ligje pleqnie e kanunerie më se perfekte. Edhe Akili u këshillua me orakullit e Dodonës para se të merrte gjakun e kushëritit dhe të mikut tij të ngusht Patroklit.



- në veprën e Homerit, që 32 shekuj më parë, spikatin tipare pellazge të trashëguara, pikë për pikë, deri të shqiptarët e sotëm, si burrëria, besa, nderi, mikpritja, zemërbardhësia për dashamirin, urretja e pafund ndaj armikut, vëllamëria, ligjërimi i trimave me kujë dhe shkulje flokësh, e shumë të tjera (Fig. – 106).
- po sjellim këtu një përjasje midis vajtimit të Akilit për bashkëluftëtarin dhe farefisin e vet Patroklit, dhe vajtimit të Lekë Dukagjinit për Gjergj Kastriotin, zakon karakteristik ky vetëm e vetëm te pellazgët, ilirët dhe shqiptarët. "...Lekë Dukagjini...vrapoi te sheshi publik, ku, duke shqyer rrobat dhe duke shkukur flokët, sokëlliu me të madhe..."⁴¹
- banorët e rreth bjeshkëve në veri tregojnë dhe këndojnë si qëmoti deri në vitet e fundit të shekullit të kaluar 16,00 vargjet e këngët së Iliadës, Odhisesë, apo të Aleksandrid të Madh?⁴²
- banorët e labërisë në Tepelenë i tregonin me kangë bëmat e Aleksandrid të Madh dhe pa gabime, dhe më vonë i dërguari i Bonapartit, Poukëvili i gjeti po aq të vërteta në muzetë e Luvrit dhe të Londrës?⁴³
- në popujt gjermanike e anglo-sakson, Druini ishte fe-perëndi, si edhe lisi emblemë, por ishte edhe lulja e lisit të Monoliza e Leonardit.
- dy zotat kryesorë, si Muji e Halili, (E.U = E.A - e ujit, M.Uji ≈ Mb'Uj dhe ENLIL ≈ ALIL ≈ HALILI) veprues në rrëfenjat Shumere janë po aq të pranishëm në Eposin Shqiptar të Kreshnikëve.⁴⁴

⁴⁰ Muzeu i Vatikanit dhe Luvrit

⁴¹ Marin BARLETI, Historia e jetës dhe e bëmave të Gjergj Kastriotit, Skënderbeu, prijësi i Epirotëve, v. 1968

⁴² Roze LANE, To the peak of the Shalë, v. 2011

⁴³ Në shkurt 1806, konsulli francez Pukëvili kalon nëpër Tepelenë. Pas plot 2004 vjetësh, kujtesa e vendasve mbante mend manovrën rrethuese të Tit Kuinkt Flamininit kundër Filipit V. Pak ditë më parë, Pukëvili kishte udhëtuar prej Borshit në Palavli (8km në veriperëndim të Delvinës), ku pat mësuar prej banorëve se fshati i tyre kishte qenë dikur qytet, i themeluar nga Pirroja. Edhe këtë burim popullor befasues, ai e fikson në veprën e vet, por siç do të shohim, duke bërë një lajthitje prej rreth nëntë shekujsh. Fjala nuk është për Pirro Burrin, por për fatosin e luftës së Trojës, Pirro Neoptolemin, stërgjyshin e Pirros ledhëzak, pra për ngjarje të ndodhura, sot e 3200 vjet më parë. Tërthorazi, kjo provonte se lebërit autoktonë të Delvinës, djep pas djepi, ishin aty zotër vendi, sikurse bashkë vëllezërit e tyre të Tepelenës, të paktën që prej 32 shekujsh. Saktësinë e gojëdhënave tona stërgjyshore e fakton edhe një bisedë e shtjelluar qëmoti midis një shqiptari nga Veriu dhe një bullgari, i cili rropatej ta bindte malësorin tonë se Ptoleminjtë ishin bullgarë, por ky i pari iu përgjigj me gojën plot: "Ne nuk i kemi Ptoleminjtë dhe Seleukët për bullgarë, e as për grekë, por i kemi për burra shqiptarë..."

⁴⁴ Anastas SHUKE, Konf. Vjetore Albshkenca, "A do të ishte Gjuha Sumere mësim për Albanologjinë", v. 2010

- muaji i parë Prill (15 Aprill -15 May), në kalendarin S(h)umerian quhet NISANNU ≈ Nis.An.a ≈ Nis.Zot.a;⁴⁵
- mund të quhet logjikisht i besueshëm, që tridhjet e dy shekuj më parë, në kohën e Luftës së Trojës, një “ishull” prej disa dhjetëra kilometrash katrore, me banorë grekë, brendapërbrenda një territori pellazg prej qindra mijë kilometrash katrore.
- Shqipëria ngeli sa 1/12 pjesë e asaj Ilire, ku 22% është racë e pastër shqiptare, si Suli, Dukagjini, Himara, Mirdita, bregu i Drinit.⁴⁶

Pellazgët – popull historik

Janë këto e më tepër arsye që shkenca e sotme – me ndonjë përjashtim fort të rrallë që vërteton rregullin, i kqyr tashmë pellazgët si një popull po aq historik sa edhe hetitët, fenikasit, hebrejtë, persianët, grekët e vjetër...Madje, studiuesi shqiptaro francez, i madhi A.Matteë jep me shumë gjasa edhe shpjegimin etimologjik të fjalës pellazg që e lidh kategorikisht me shqipen. Duke i interpretuar të gjithë studiusit së bashku, madje në disa mënyra arrijmë në përfundimin se gjithsesi koncepti apo termi pellazg lidhet vetëm me shqipen. P.sh:

1. me terrmin pellazgji, ai nënkupton ata burra e njerëz të lindur apo pjellë në pyje, gegënisht pellë-pyll dhe gji-njerëzi.
2. a nuk do të thojë gjithsecili studius se nga errësira e akullnajës së fundit, apo nga hiri vullkanik i viteve 12,000 para krishtit apo nga përmbytja e madhe dolën apo mbijetëuan disa njerëz, që jo rastësisht, quhen të pjellë nga ky pyll në kuptimin errësirë, egërsi.
3. ose një shpjegim tjetër⁴⁷ po aty, lidhet me konceptin si njerëz të dalë nga shpella, guva. A nuk është e vërtetë, se ende sot, njerëzve të tillë ne iu themi pellazg apo shpellar. Pastaj dhe e vërteta kështu është, ku njeriu homo sapiens sapiens që i mbijetoi akullnajimit të fundit këtu e 25,000 vjet para zboi ariun nga shpellat për të jetuar vetë, dhe mbasi u ngroh koha në vitet 10,000 para krishtit zbriti në fusha dhe atë që ndërtoi për banesë e quajti gjene si dikur shpellë-shpi, si askush komb tjetër në botë.
4. pelagji nënkupton edhe njerëz të angazhuar me pela, ku me të vërtetë këta primat europianë apo shqiptarë njihen si njerëz të tillë, që risnin dhe stërvisnin pela, kuanj. Jo rastësisht, kryeqendra e magedonisë quhej Pelia. Jo rastësisht, Aleksandri i Madh diti të zbuste kalin super të egër buqefalin, sepse ai ishte bir the stërnip i popujve thrak, frigjianë, trojanë ose moskë (mushki), që të gjithë vllazër të pellazgëve ose vetë ata.
5. pellazgët mund të merren si njerëz të pjellë në Argos, kryeqendra dhe zanafilla e tyre. Madje, sipas legjendës, edhe mbreti i fundit i Argolidës (Argos sot) quhej pelazgos. Po sot në këto zona, diku pranë termopileve, ka ende emërtime apo toponime me emrin pellazgos, ku kujtesa e popullit këto tre mijë vjet nuk ka mundur të fshij dot historinë apo gjurmën qysh 10,000 vjet.

PËRFUNDIMI DHE SINTEZA

Të gjithë autorët e lashtë, ndër të cilët dhe Homeri, Hesiodi, Hekate i Miletit, Herodoti, Efori na bënë të ditur se përpara mbërritjes së grekëve, vendi që do të bëhej Greqi ka qenë i banuar nga Pellazgët dhe pohojnë se pellazgët nuk ishin grekë, por “barbarë - jo grekë”.⁴⁸ Asnjë tregues nuk ka pohuar ekzistencën

⁴⁵ Po aty,

⁴⁶ SHNEIDER, *Une race oubliée, Les Pelasges et leurs descendantes*, v. 1894

⁴⁷ Aref MATHIEU, *Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen*, fq. 318, v. 2007

⁴⁸ Sgarojmë se “Romak apo grek” përcaktonte një kategori kostitucionale dhe jo etnike, në çfarëdo qoftë kuptimi. Ndërkohë që fjala “barbar”, përkundrazi, përcaktonte një kategori të sajuar, e përdorur për shumë kategori popujsh dhe e veshur me shume paragjykime të shtrezëzuara ndër shekuj te etnografisë klasike. Megjithkëtë, edhe pse romakët e grekët nënvizonin hendekun që

e Grekëve para shekulli VIII. Homeri, nuk i ka cituar helenët, as si popull e as si komb grek. Madje, në një rast lidhur me trashëgimin e armëve të Akilit, Homeri citon në vargjet e veta se: *Aethiopsis zgjidhet si i vetmi luftëtar pellazg, që meriton të trashëgojë armët e Akilit pellazg.*⁴⁹

Këtë fakt na e sjell edhe studiuesi i kohëve të sotme, juristi dhe orientalisti i mirënjohur grek N.P.Eleftheriadhi në veprën e tij „Greqia Pellazgjike Para-Helene“, i cili pohon se: *sipas dëshmiave të të lashtëve, ata të njëjtët popuj që banuan veçanërisht në trojet greke, banuan shumë kohë më parë, bile shumë më parë se të shpërthejë Lufta e Trojës, në mbarë Italinë, në Siçili, në Azinë e Vogël, në Gadishullin Iberik, në Francën Jugore dhe në shumë vende të tjera, ku flitej e njëjta gjuhë pellazgjike, shumë kohë më parë se të arrinin Grekët në trojet e tyre të sotëm.*⁵⁰ dhe po këtë llogjikë vazhdon e thot Nermin Vlorase:

*prandaj dhe gjuha greke u formua në strukturën e saj përmbijetese, nga gjuha shumë e pasur Pellazgjike.*⁵¹

Disa mendojnë se grekët dhe fenikasit kanë banuar përbri njëri-tjetrit. Kësisoj, Grekët janë fryt i një përzierje shumë të hollë midis Pellazgëve autoktonë dhe pushtuesve të parë semito- egjiptianë. Grekët e nisnin historinë e tyre me Lojërat Olimpike në vitin 776 para Krishtit, por kjo datë sipas autorëve duhet kthyer 60 vjet pas, rreth vitit 716. Në epokën historike, grekët në grindje për tokat kërkonin me ngulm të kaluarën legjendare në mënyrë që të përlligjin pretendimet e tyre. E gjithë kjo, kryhet në Greqi në një hapësirë kohore prej 100 vjetësh midis shek. VIII dhe dhjetëvjeçarit të parë të shek. VII.

2. PËRFUNDIME

Të gjitha studimet mbi pellazgët përfundojnë se:

1. Ishin një popull i zgjedhur i racës njerëzore, të cilët krijuan një qytetërim admirues qysh 12.000 vjet para kr.
2. Pellazgu ishte i biri i tokës i lindur nga dhéu, njeriu i parë i lindur në këtë vend. Pellazg, njeri i lindur i dhéut pohon Spiro Kondo në librin e tij ‘Shqiptarët dhe problemi pelasgjik’. Pellazgët, thotë Herodoti në librin e II, nuk i thërisnin perënditë me emër, ata i thirrën me emra perënditë e tyre shumë vonë.
3. Pellazgët, tempullin kryesor të tyre e kishin në pyllin e Dodonës pohohet gjatë trajtimit të këtij problemi nga historiani i kohës moderne Mishels.
4. Emri pellazg erdhi nga mbreti i tyre që quhej Pelasgius dhe që ishte i biri i Zeusit, por emrin e lidhin edhe me fjalën shqipe pellg-pellasgoi, me të cilën Plutarku indentifikon Peloponezin.
5. Pellazgët ishin një nga popujt më të zhvilluar të botës së lashtësisë, përpara ilirëve, grekëve dhe maqedonasve që populluan Egjeun fillimisht, dhe lëvizën në Afrikën veriore, në Itali, në pellgun e Mesdheut, në brigjet e detit të Zi, deri në Indi e Kaukaz në lindje e në brigjet jugore të gadishullit Iberik në perëndim.
6. Pellazgët që mbizotëronin në Adriatik i kanë sjellë Europës alfabetin e parë, qytetërimin më të lashtë, themelet e shkencës, mitologjinë, etj.
7. Ata kanë qënë një popull punëtor që merreshin me blegtori, bujqësi, gjueti e peshkim, një popull që ka hedhur themelet e qytetërimit mesdhetar dhe që dallohen për origjinalitetin e besimit fetar.
8. Pellazgët bëjnë pjesë në familjen europiane të kombeve dhe mendohen si popull i natyrës, në të cilën i ka rrënjët edhe koncepti i tyre për besimin fetar.

i ndante, këto dy kategori kulturash më tepër nuk e përjashtonin domosdoshmërisht njera tjetrën, përkundrazi nuk jetonin dot pa njera tjetrën.

⁴⁹ Homeri, *Iliada*, v. 2006

⁵⁰ N.P.Eleftheriadhi, ‘Greqia Pellazgjike Para-Helene’, fq. 124, Athinë, v. 1931

⁵¹ Po aty fq. 133, sipas citimit të Nermin Vlorë Faskit, ‘Gjuha Etruske jeton’, fq. 18, v. 1989

9. Hyjnizimi i natyrës vihet re në adhurimin e qiellit, yjeve, hënës, tokës, vetëtimave, erës, pyjeve, etj. Ky adhurim i evidenton pellazgët si adhurues të natyrës, si besimi më i hershëm i shoqërisë njerëzore.
10. Adhurimi i tyre për natyrën përqëndrohej në faktoren e famshme të Orakullit të Dodonës nga më të vjetrit e Europës, që njihet edhe si tempull i Zeusit në Epir.
11. Pa dyshim, burimi më i madh i të dhënave për pellazgët janë poemat e pellazgut për tokën si nëna që na ushqen gjithë vdekëtarët, poema e pellazgut të verbër të Homerit, Iliada dhe Odiseja, pas të cilit Mbreti Danei nxori një ligj, ku të gjithë ata që më parë quheshin pellazgë do të quheshin Danei.
12. Kultura e Mikenës të dëftën për një komb sa bujar e mikpritës, që jo vetëm të kujton sjelljet e sotme tipike shqiptare, por edhe epitetin ky komb e ka marr për shkak të karakterit mikpritës – Mik-ena. Mos u çudisni se emrat e kombeve asokohe, kësisoj jepeshin.
13. Edhe Kreta të dëftën për një lloj kombi me karakter të fortë, që kur thonë me dhjetra studius etnograf e albanolog, se çka një lidhje midis malësorëve të skocisë, atyre të shqiptarëve gegë dhe atyre në Kretë.
14. Nga ana tjetër, Kreta përbën majën apo kokën e trevës që kanë banuar qysh në fillimet e veta paraeuropianët apo pellazgët, duke filluar nga paraleli një, njëshi, sot Nishi deri në paralelin e shtatë në krye ose Kre, pra Kretë, sepse kjo ka qenë gjerësia gjeografike e banimit të pellazgëve për mijra vjet. Dhe paraleli i tetë është ai deri në Tebë të Egjyptit.
15. Në veprat Iliadë dhe Odhise të rapsodëve pellazg të asokohe, pastaj më vonë nga vetë Homeri, kurrë nuk janë përmendur emra e fise me origjinë hellade, greke, duke e tipizuar këtë luftë si midis vetë fiseve pellazge për xhelozinë e bollëkut dhe për korridorin tregtar që ajo zotëronte. Ju kujtojmë Konstandinopojën, pse u shkatërua, apo dhe/ose Voskopojën.

Problemi qendron sikundër thot studiusi shqiptar Arsim Spahiu te historianët shqiptarë:⁵² *që nuk binden se kapitujt më të lavdishëm të historisë së vjetër të Shqipërisë janë shtrembëruar rrënjësisht, për t'u grabitur plotësisht.*

Deri më sot, vetëm një gjuhë është e aftë të hedhë dritë mbi këto sendërti: kjo është gjuha shqipe. Prandaj autori mbështet tezën se shqiptaret e sotëm janë pasardhës të popullsisë, e cila jetonte para ardhjes së grekëve në trevat përgjatë Adriatikut e deri në Halis, ky një lumë në lindje të Azisë së vogël.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

⁵² Arsim SPAHIU, *Shteti Epirot*, fq. 64, v.2011